



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.4.2026, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i Komitetit, Amir Simnica - LDK, Dhurata Jahaj-Retkoceri - LDK, Leutrim Retkoceri - PDK, Fjolla Vukshinaj-Reçica - PDK, Agron Canolli - PDK, Gëzim Sveçla - LVV, Nora Kelmendi - LVV.

Munguan: Kreshnik Smajlaj - AAK.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi i Komitetit z. Fehmi Kupina, me këtë:

R E N D T Ë D I T Ë S

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim – vendim për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale 2026 – 2028;
3. Propozim – vendim për lënien në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores me nr. 01-110/1205,(K.Pr) për shërbimin e transportit me “Merimangë” për territorin e Komunës së Prishtinës;
4. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr.01-030/ 01-236535/23 (K.Pr), për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;
5. Raporti konsolidues i performancës financiare dhe operative të Ndërmarrjes “Prishtina Parking”;
6. Propozim – vendimi për subvencionimin e NPL “Prishtina Parking”;
7. Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit (TM1) 2026;
8. Propozim – vendimi për bartja e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026;
9. Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale me nr. P-71914059-06118-1 dhe P-71914059-06119-3 për NP “Termokos”, SH.A;

Faqe 1 nga 11

10. Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale nr. P-71914059-07090-21 për NP “Termokos”, SH.A;
11. Rregullore për plotësim ndryshimin e Rregullores për menagjimin e varrezave dhe objektit komemorativ në Komunën e Prishtinës;
12. Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për “Muzeun e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë.

Pika e dytë

Propozim – vendim për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale 2026 – 2028.

Adelina Sahiti: – tha se ne në seancën e kaluar e kemi pasur pikën e rendit të ditës për Planin e veprimit për shërbime sociale dhe familjare për tri vitet e ardhshme të cilin jemi munduar t’i marrim të gjitha komentet, vërejtjet që kemi marr nga kolegët nga subjektet politike.

Ajo në vazhdim tha se deri më datën 1 e kemi dorëzuar tek kryesuesi dhe nuk kemi marr asnjë koment përkundër thirrjeve të mia dhe kërkesave prej kolegëve që të na dorëzojnë komentet në kanalet tona zyrtare. Mirëpo unë nuk kam marr asnjë koment të vetëm deri pasi që është dorëzuar. Pra kur është dorëzuar po atë ditë Grupi Parlamentar i LDK-së, grupi i asamblistëve ka dërguar komentet tona të cilat kanë qenë përafërsisht të ngjashme. Por ne e patëm dërguar tek kryesuesi për shkak se pritëm thuajse dy javë dhe nuk pati asnjë koment nga ato reagimet që u bënë atë ditë në ato debatet e mëdha që i zhvilluam. Por besoj se edhe ato të LDK-së mundemi t’i trajtojmë nesër dhe në anën tjetër mund të inkorporohen sepse janë të ngjashme me ato që i kemi në pikat e Planit të veprimit. E dini i ka katër objektiva strategjike dihet roli dhe funksioni i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për të ofruar shërbime sociale në tërë territorin e Komunës së Prishtinës për të gjitha grupet e cenuara. Pra në këtë plan jemi munduar që të jemi real, dhe çka kërkoj nga ju edhe si grupe parlamentare të jeni më të zëshëm që në buxhetin kur te bëjmë për vitin 2027 të ketë më shumë vëmendje dhe më shumë fokus mirëqenia sociale, sepse jemi dëshmitar se çdo ditë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë shumë të mëdha për shërbime sociale.

Nora Kelmendi: – shtroi pyetje se a është dërguar emaili tek krejt grupet e asamblistëve që po priten komentet, se p.sh., si e ka ditur LDK-ja se duhet të dërgohen komentet për deri sa ne nuk e kemi ditur se kemi pasur dy javë afat për me i dërguar komentet.

Adelina Sahiti: – tha se unë dy javëshin e thash në formë jo të afatit se, d.m.th., e kemi pasur një dedlajn prej kryesuesit për me i dërguar pikat e rendit të ditës dhe ne kemi pritur deri në atë ditë deri në ora 12:00 dhe nuk kemi pasur.

Ajo në vazhdim tha se unë e kam thënë publikisht dërgomëni komentet se ne kemi marr diçka shënime, por megjithatë duhet thënë se prej kabinetit të kryetarit i kanë mbajtur disa shënime dhe m'i kanë përcjellë këshilltarët e kryetarit në planin që ju e keni, jemi munduar por në anën tjetër fatkeqësisht nuk kemi pasur asnjë koment.

Nora Kelmendi: – shtroi pyetje se, a ka mundësi që sot të ju dërgojmë komentet e grupit tonë me i vendosur në rregullore që për nesër t'i kemi në seancë.

Adelina Sahiti: – tha se janë inkorporuar dhe nuk e di se sot për sot sa mundemi me i fut me i fuzionuar sepse nuk duket korrekte, nuk duket profesionale pasi që besoj se një pjesë e madhe janë inkorporuar.

Leutrim Retkoceri: – lidhur me rekomandimet nga ana e asamblastëve tha se atë ditë në seancë ka pasur rekomandime nga ana e asamblastëve dhe ka qenë mirë që ato rekomandime me i marr dhe me i vendosur në Plan të veprimit e pastaj me i dërguar si material.

Ai në vazhdim tha se po ashtu edhe nga grupi i PDK-së e ke pasur një kërkesë eksplicite që në Plan të veprimit nuk është marrë parasysh komenti për autizëm, ku as sot plani as sot nuk ka ndonjë shoqatë që do të përfshihet në hartimin çoftë të planit të veprimit, çoftë të konsultave thua si drejtori. Ku kjo ka qenë thelbi dhe çështja çka është diskutuar prej grupit të PDK-së.

Adelina Sahiti: – lidhur me diskutimin e z. Retkoceri tha se jo vetëm një shoqatë por janë katër shoqata të autizmit të cilat janë të përfshira dhe janë gjithmonë fituese më të mëdha të subvencioneve që ofrojmë. Pra, janë “Shoqata e Autizmit”, “Shoqata Autizmi flet”, është “Anaku” Asociacioni Nacional i Autizmit të Kosovës, po ashtu është edhe Qendra Logopedike “Z” e cila po ashtu prej se jemi ne si udhëheqësi po flas prej katër vitesh gjithmonë janë me shumën më të madhe që na japin për shkak se e dinë se ne ofrojmë shërbime direkte konkrete për fëmijët e prekur me autizëm.

Leutrim Retkoceri: – lidhur me diskutimin e znj. Sahiti tha se nuk ka rëndësi se a ka shoqata apo nuk ka të cilat janë ndihmuar por ideja kyçe është me e zgjidhur këtë që edhe ti po e ngritë.

Ai në vazhdim tha se nëse nuk ka persona që merren me trajtimin e personave të rritur me autizëm është pikërisht përfshirja e shoqatave në hartimin e planeve, në hartimin e planit të veprimit si dhe me u shënuar specifikisht për me të ndihmuar edhe ty që gjatë diskutimeve dhe hartimeve të planeve në të ardhmen pavarësisht subvencioneve me siguruar persona që e ndihmojnë çështjen.

Fjolla Vukshinaj-Reçica: - lidhur me Planin e veprimit tha se duhet bërë disa përmirësime si p.sh., qysh në fillim pra në hyrje që ka të bëjë me përkrahjet e Prishtinës, ku ndoshta do të ishte më mirë mos me i shfrytëzuar apo mos me i shkruar hiq në planet e

veprimit qysh kishte me dal dokumenti më serioz. Po ashtu edhe aty tek ekonomia nëse kishit mundur me i marr të dhënat e fundit tek pjesa e të punësuarve meqë na e ka dërguar raportin drejtoresha e financave nuk janë të njëjtë me pjesën e shkruar në planin e veprimit nëse mundesh me i barazuar.

Ajo mes tjerash tha se më pëlqeu shumë pjesa e monitorimit pasi që unë kam punuar në projekte të rëndësishme planin emel, mirëpo të kisha rekomanduar që me pasur një bashkëpunim shumë më të mirë me OJQ-të që ato me të ndihmuar shumë tek pjesa e monitorimit dhe vlerësimit.

Pika e tretë

Propozim – vendim për lënien në diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores me nr. 01-110/1205,(K.Pr) për shërbimin e transportit me “Merimangë” për territorin e Komunës së Prishtinës.

Luftar Braha: – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se kjo pikë ka të bëjë me shërbimin me merimangë, shërbim i cili është duke na munguar e para për shkak të çmimit, e dyta për shkak të mënyrës së kontraktimit të kompanive dhe e treta për shkak të ngarkesës në qytet që kanë kamionët bartës të cilët dalin në qytet ngelen në trafik munden me i shërbyer 2-3 vetura e jo më shumë.

Ai në vazhdim tha se ne duhet me e rritur si shërbim por duhet me e menduar edhe rritjen si çmim.

Prandaj për mos me i dhënë vetes apo drejtorisë të drejtë me e përcaktuar çmimin jemi menduar me e nxjerr në diskutim publik me e bërë të hapur diskutimin dhe me e parë se ku po arrijmë.

Mirëpo një prej pikave kryesore është ndryshimi i çmimit dhe i kontraktimit, ku ndoshta është mundësia me i licencuar kompanitë edhe ato me qenë të licencuara përmes Komunës, kompanitë të cilat ofrojnë shërbime me merimangë thirren prej policisë apo prej inspeksionit e japin shërbime mbulojnë zonat e caktuara ashtu që i lirojmë trotuaret, parqet dhe hapësirat publike.

Nora Kelmendi: – shtroi pyetje lidhur me diskutimet publike që po bëhen në përgjithësi për rregulloret a i dërgoni edhe nëpër bashkësitë lokale se shumica nuk kanë qasje në web-faqe të komunës se ata nuk e dinë se kur janë diskutimet publike.

Luftar Braha: - lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Kelmendi tha se nuk e di se si ka qenë praktika e mëhershme dhe si është bërë, por ne e kemi rregulloren që e kemi kaluar në seancën e kaluar sot e kemi marr listën e të gjithë kryetarëve të bashkësive lokale qysh kishim me jua dërguar dhe me i njoftuar, ku po mundohemi me i krijuar të paktën praktikat e tilla të cilat i përfshijmë dhe i involvojmë sepse këto nuk janë vendime dhe rregullore që kanë të bëjnë me qeverisjen por kanë të bëjnë me bashkëjetesën në kryeqytet.

Pika e katërt

Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr.01-030/ 01-236535/23 (K.Pr), për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.

Faqe 4 nga 11

Luftar Braha: - tha se ky plotësim ndryshim i rregullores për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës bie si rezultat i Gjykatës Supreme. Vendim i cili e ka pamundësuar shumë veprimin apo e ka kufizuar shumë fushëveprimin e Ndërmarrjes “Prishtina Parking”, po ashtu kanë nxjerr probleme të tjera që janë shfaqur në terren.

Ai në vazhdim tha se në të gjitha pikat të cilat janë atakuar ose në të cilat ka marr vendim Gjykata Supreme janë të rishqyrtuara dhe të futura në këtë plotësim ndryshim të rregullores, d.m.th., është i bazuar vetëm në vendimin e Gjykatës Supreme.

Pra mendoj se nuk ka nevojë as për diskutim publik sepse është thjesht vendim i Gjykatës Supreme i cili duhet të zbatohet edhe duhet të reflektohet në zbatim në rregullore.

Leutrim Retkoceri: – duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Braha tha se pavarësisht se ka vendim të Gjykatës Supreme për rregulloren është udhëzimi administrativ që i përcakton hapat që të gjitha rregulloret edhe nëse një nen ndryshohet duhet të shkoj në dëgjim publik. Dëgjimi publik gjithashtu i kontribuon rregullores me sqaruar edhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë sepse vendimi i Gjykatës Supreme po e marr shembull e ka caktuar një rast që të hiqet kufizimi për parkingjet në kryeqytet pra kufizimi kohor. Pra si do të reagoj Komuna për të rregulluar këtë çështjen e kohës për banorët rezidentë të lagjes, d.m.th., është çështje që duhet të gjendet një ide që i përshtatet banorëve rezidentë por në të njëjtën kohë nuk e shkel edhe vendimin e Gjykatës Supreme.

Prandaj si do të reagoj komuna për ta rregulluar këtë çështjen e kohës për banorët rezident që janë të lagjes. Si dhe çështja tjetër siç e patëm edhe tek drejtoresha e financave ishte ajo që ka të bëjë me subvencionimin për ndërmarrje që është kthimi i mjeteve apo gjobave që i bënë inspeksioni tek Ndërmarrja “Prishtina Parking”, se rregullohet ajo çështje që mos me ardhur çdo muaj në Kuvend me u bërë me subvencionim kalimi i mjeteve prej komunës tek ndërmarrja. Do të thotë këtë duhet saktësuar atë çështje me rregullore sepse vendimi i Gjykatës Supreme ta jap aktin përfundimtar.

Luftar Braha: – lidhur me diskutimin e z. Retkoceri tha se nëse është udhëzimi administrativ i tillë nuk kemi çka të themi tjetër ajo duhet zbatuar.

Gëzim Sveçla: – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se përpos aspektit ligjor që është i domosdoshëm sepse rregullorja për miratimin e akteve e shpreh qartë se një rregullore mundet të ndryshojë vetëm përmes diskutimit publik.

Ai në vazhdim tha se mendoj se është koha se përpos këtyre të cilat që janë të gjetura apo që janë vendime se këto janë vendime të Gjykatës Supreme me e shqyrtuar rregulloren si tërësi nëse ka diçka që mundemi me e përmirësuar pasi veç po del në diskutim publik.

Luftar Braha: – duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Sveçla tha se jam dakord se ndoshta do të ishte mënyra më e mirë për të funksionuar dhe me ecur përpara. Po ashtu edhe unë personalisht kam mendim se është dashur me ndërhyrë edhe në pikat tjera mirëpo synimi ka qenë me e përmbush një herë vendimin e Gjykatës Supreme.

Pika e pestë

Në mungesë të zyrtarit kompetent të kësaj ndërmarrjeje kjo pikë e rendit të ditës është lënë për diskutim në seancën e radhës.

Pika e gjashtë

Propozim – vendimi për subvencionimin e NPL “Prishtina Parking”.

Valbona Makolli: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se në emër të kryetarit ju njoftoj se kërkesa ka ardhur diku 700 mijë euro për subvencionim të obligimeve tek kjo ndërmarrje, për shkaqe të njohura për rregulloren e cila është kthyer. Pra ju njoftoj se deri në këtë moment deri sa po raportoj d.m.th., deri sot kryetari i ka vetëm 638 mijë euro në subvencione.

Ajo në vazhdim tha se kemi pasur takim, nënkryetari z. Dushi me NPL “Prishtina Parking” dhe kanë arritur marrëveshjen që asaj ndërmarrje të ju huazohen 500 mijë euro nga të hyrat vetanake, të projekteve, të mallrave dhe shërbimeve si dhe me nënshkruar një marrëveshje në mes komunës dhe ndërmarrjes. Kështu qysh ajo ka me e bërë kthimin e atyre mjeteve të cilat janë vetëm si huazim e jo subvencionim. Ndërsa për detaje do të informoheni nga zyra ligjore nesër.

Nora Kelmendi: – duke u ndërlidhur në diskutim tha se kërkojmë bazën ligjore nga zyra ligjore.

Leutrim Retkoceri: – lidhur me subvencionimet pasi që ka të bëjë me financa shtroi pyetje se nga kush ka ardhur propozimi për subvencionim.

Valbona Makolli: - tha se propozimi ka ardhur prej shefit në detyrë të NPL “Prishtina Parking”.

Pika e shtatë

Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit (TM1) 2026.

Valbona Makolli: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 janar – 31 mars 2026, është periudhë e tremujorit të parë i vitit 2026, ku janë paraqitur detalet edhe pse këtu nuk kemi pasur çka me diskutuar për arsye se deri në fund të marsit 2026 kemi punuar me 1/12 e vitit 2024 pasi që nuk kemi pasur buxhet për vitin 2025. Ku në fillim të marsit janë bërë ndryshimet apo barazimet me Ministrin e Financave dhe kemi vazhduar me buxhetin e vitit 2026.

Ndërsa sa i përket performancës së të hyrave për mos me ju marr kohë, siç e dini është në nivel më pak për arsye se në mars është pritur se pagesa e tatimit në pronë si pagesa më e madhe komunale. Mirëpo ajo është shtyer për shkaqe të sistemit të tatimit në pronë mos printimit apo mos shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë deri më 30.9.2026, kështu që edhe njëherë për shkak të ndryshimeve dhe përsëritjes së disa borxheve të cilat i kanë vërejtur edhe ashtu nuk kanë bërë pagesa dhe jemi në rënje të të hyrave që do të thotë se arsyeja e vetme është kjo. Mirëpo shpresoj se kjo tash është rregulluar dhe është bërë

shpërndarja e faturave të tatimit në pronë dhe do të vazhdojmë me mbledhjen e këtyre të hyrave.

Sa i përket performancave të shpenzimeve për këtë periudhë raportuese është 27 milionë e 663.593 apo 37.38%. Këtu nuk ka pasur ndonjë ndryshim, ndryshimi i vetëm që e ka bërë këtë vlerë është tek kategoria e pagave dhe shpenzimeve dhe mëditjeve për shkak të pagës së trembëdhjetë e cila është grant qeveritar, e cila është paraqitur si vlerë monetare dhe është shpërndarë. Kjo nuk ka qenë e planifikuar dhe kjo e ka rritur këtë vlerë se nuk ka asnjë të punësuar apo ndonjë ndryshim tjetër vetëm se rritja tek kjo kategori e cila është më e theksuar e cila është paga e trembëdhjetë.

Ndërsa tek mallrat dhe shërbimet është një rritje e vogël prej 28.14%, për shkak se kjo do të na përcjell deri në fund të vitit, sepse jemi gati një vit në vonesa për shkak të buxhetit 2025, mirëpo obligimet dhe shërbimet janë pranuar prej të gjithë operatorëve dhe shërbimeve të tjera.

Kurse sa i përket shpenzimeve kapitale është normal, jo e kënaqshme por edhe nuk është bërë ndonjë pagesë që ka qenë borxh për arsye se siç e dini alokimi është bërë shumë me vonesë.

Për mos me hyrë në ndryshimet të cilat janë kërkuar sqarimet p.sh., tek të hyrat është një 4 milionë euro e cila është paraparë me rregulloren e re pas kalimit të saj grumbullimi i të hyrave dhe taksave të reja të cilat do të bëhen.

Kurse tek shpenzimet nuk kam diçka që me e vërejtur përveç që është kërkuar në asamblenë e kaluar që të qitet edhe një rubrikë për rastet përmbarimore të cilat nuk do të hyjnë në përqindje të realizimit të pagesave vetëm se do të jetë si një njoftim për ju dhe qytetarët.

Gëzim Sveçla: – shtroi pyetje lidhur me kontratat për shërbime të veçanta e kam parë një tabelë sipas të cilës për rreth 108 personave është rritur numri vetëm prej fundit të vitit të kaluar. Do të thotë në fund të dhjetorit kanë qenë 97 nëse nuk gaboju ndërsa tani janë bërë 100 e diçka gati 200.

Nëse kishit mundur të thoni diçka për këto kontrata të veçanta, d.m.th., për tre muaj ditë janë realizuar 100 e sa punësime përmes kontratave për punë të veçanta.

Valbona Makolli: - lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Sveçla tha se këto janë të dhënat të cilat i kemi marr se ato kanë qenë gjatë gjithë vitit, por unë kisha propozuar që ju nesër të ju bëni pyetje drejtorëve që i kanë marr në emër të projekteve.

Fjolla Vukshinaj-Reçica: - duke u ndërlidhur në diskutim tha se më vjen mirë drejtoreshë që keni marr këtë rekomandimin që ta shtoni kolonën për përmbarues d.m.th., buxhetin sepse po e tregon raportin më të qartë dhe po jap njëfarë transparence se sa përqind është realizuar projekti dhe sa ka shkuar në pjesën përmbarimore.

Pra do të ishte mirë që këtë praktikë me e përdorë gjithmonë pra edhe në raportin vjetor.

Valbona Makolli: – lidhur me diskutimin e znj. Vukshinaj tha se ajo çka nuk e prish konstruktin e raportit jeni të mirëseardhur, se edhe ju jeni pjesë e qytetarëve që kjo pas kalimit të afati ligjor publikohet.

Mirëpo problemi është se ne kemi kërkuar takim me Ministrinë e Financave me e sqaruar se tani normal përveç këtyre kanë marr, edhe jashtë kësaj në muajin prill para një jave por

kemi takimin ndoshta është bërë gabim se ashtu si e kanë marr ata nuk mundemi me raportuar, por është çështje sa për informatë sepse kjo vazhdon deri në fund se kjo rubrikë nuk hiqet deri sa të kryhet.

Pika e tetë

Propozim – vendimi për bartja e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026.

Valbona Makolli; – tha se sa i përket vendimit për bartjen ose tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2025, ju njoftoj se vlera është 10 milion e 811.713. Këtu janë të përfshira vetëm të hyrat që kanë mbetur të muajit dhjetor deri në fund të vitit të cilat alokimet bëhen me 12.12, ku më shumë ato zakonisht barten.

Ndërsa pjesa tjetër është prej policisë, gjobat e të tjera.

Këto mjete normal që nuk janë të mjaftueshme për obligimet të cilat i kemi, arsyetimi pra dihet mos t'a përsërisë që nuk kemi pasur buxhet. Ndërsa në paga dhe mëditje do të alokohen menjëherë 60 mijë euro, se është në pyetje kategoria ku janë shkollat profesionale të cilat grumbullojnë të hyra për atë mësimin që e mbajnë, zakonisht i qesin të hyrat për atë pjesë të stafit dhe të shkollës “Abdyl Frashëri”.

Ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime janë në detale secila kanë kontrata, shumica prej tyre janë mbi tavolinë në Drejtorinë e Financave duke pritur alokimin e mjeteve.

Pika e nëntë

Propozim – vendimi për dhënien në shfrytëzim të pjesëve të parcelave kadastrale me nr. P-71914059-06118-1 dhe P-71914059-06119-3 për NP “Termokos”, SH.A.

Në mungesë të drejtorit z. Ibrahim Mehmetaj shtyhet për takimin e ardhshëm.

Pika e dhjetë

Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim të një pjese të parcelës kadastrale nr. P-71914059-07090-21 për NP “Termokos”, SH.A.

Në mungesë të drejtorit z. Ibrahim Mehmetaj shtyhet për takimin e ardhshëm.

Pika e njëmbëdhjetë

Rregullore për plotësim ndryshimin e Rregullores për menagjimin e varrezave dhe objektit komemorativ në Komunën e Prishtinës.

Nora Cimili; – tha se siç e përmenda në fillim prej marrjes së mandatit të kryeshefes ekzekutive në Ndërmarrjen “Hortikultura” tani “Gjelbër” kam vërejtur një diskrepancë të hyrave dhe shpenzimeve që i kemi në këtë pikë. Ajo në vazhdim tha se edhe rregullorja i reflekton këto ndryshime ose këto nevoja. Rregullorja të cilën e kam dërguar daton prej vitit 2015 e cila është ndërruar qysh atëherë dhe nuk kam ndonjëfarë përcjellje se çka është bërë por rrjedhimisht në vitin 2005. D.m.th., prej ndërmarrjes “Higjieno Teknika” i janë kaluar kompetencat Hortikulturës për me i mirëmbajtur dhe me i kryer shërbimet e varrimit për qytetarët e Prishtinës. Pra prej asaj kohe ndërmarrja funksionon me ato çmime d.m.th., prej kohës së UNMIK-ut janë caktuar ato çmime. Kështu që rrjedhimisht për njëzet vjet

qytetarët e Prishtinës paguajnë 46 euro për hapjen dhe mbylljen e një varri. Me dallim me komunitet tjera ku kemi bërë një grup punues i cili është marr me dallimet se sa kushtojnë këto në komunitet e tjera, me krahasimin me komunitet tjera çmimet shkojnë deri në 320 euro. Ajo në mes tjerash tha se për shkak të ligjit është paraqitur nevoja që kjo pikë e rendit të ditës me u ndryshuar ku kemi kërkuar prej anës së ndërmarrjes me u plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja për menaxhimin e varrezave e cila menaxhohet nga ana e ndërmarrjes, sepse parashihet të del në dëgjim publik. Ajo në vazhdim tha se dokumentet i kam dërguar përmes emailit me siguri i keni parë, si dhe janë bashkangjitur dokumentacioni se çka kemi bërë, po ashtu edhe i grupit punues të rregulloreve dhe vendimeve të mëhershme ku besoj se të njëjtat i shpërndani edhe tek asamblistët e tjerë. Pra titulli i pikës të jetë: **Dëgjim publik për Propozim – vendim për plotësim, ndryshim të Rregullores për rregullim të varrezave.**

Gëzim Sveçla: – lidhur me diskutimin e znj. Cimili tha se qëllimi kryesor i Ndërmarrjeve Publike Komunale është me ju shërbyer qytetarëve edhe me e shërbyer qytetin. Ndërsa në rastin për të cilin po flasim d.m.th., për varrezat e ka njëfarë ndjeshmërie të veçantë si rast, ne vitin e kaluar e kemi rritur atë shumë ku me të renë është 300 euro, dhe duhet të kujdesemi që ata të cilët kanë raste të vdekjes në familje dhe që kanë nevojë për këto shërbime që ju ofron ndërmarrja me e përmbyll me këtë ciklin me atë 400. Ai mes tjerash tha se e mira e gjithë kësaj është që propozimin të cilin e bëtë në fillim që kjo me dal në dëgjim publik, pasi që unë mendoj se rregullorja është e tejkaluar, pra pajtohem se duhet me dal në dëgjim publik dhe duhet dëgjuar propozimet e gjithë opinionit.

Nora Cimili:- tha se çmimet të cilat i kam propozuar janë prej komisionit punues të cilët e kanë vlerësuar përmes komunave tjera, pra besoj se nuk duhet të jetë më e shtrenjtë ndonjë komunë tjetër se Prishtina.

Gëzim Sveçla: – lidhur me diskutimin e znj. Cimili tha se unë po e kuptoj këtë këndvështrimin tëndë prej pozitës së kryeshefes së ndërmarrjes ku qëllimi është mbarëvajtja çoftë financiare, çoftë stabiliteti financiar edhe i punëve të ndërmarrjes. Ai në vazhdim tha se kur e kemi bërë propozimin për rritjen e subvencionimit për rastet e varrimit janë të vlerësuara ose të përlogaritura përafërsisht të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me varrimin e një personi duke përfshirë të gjitha ritualet fetare.

Amir Simnica: - duke u ndërlidhur në diskutim tha se e kam lexuar rregulloren dhe e pash se diferenca në mes të Prishtinës dhe komunave të tjera është goxha mirë por tek çmimet e reja që ju pretendoni si ndërmarrje t'i keni, edhe unë i kam dy pika tek dy kolonat d.m.th., tek hapja dhe mbyllja e gropës së varrit dhe tek piramidat informuese. Ai në vazhdim tha se vërtet çmimi 46 euro është i ulët mirëpo e mira e kësaj është se do të del në dëgjim publik se ngritja në 200 euro më duket se është shumë e lartë, pra tani do të mbetet që gjatë dëgjimit publik të vendoset, ku besoj se gjatë dëgjimit publik do ta gjejmë mesataren që ndërmarrja te formoj mirë.

Nora Cimili: – duke u ndërlidhur në diskutim tha se siç e biseduam edhe me Gëzimin se e mira është që del në dëgjim publik, edhe pse e di se është një barrë e rëndë edhe se nevoja ka qenë qysh më herët me u ndërruar.

Leutrim Retkoceri: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se është mirë që rregullorja të shkoj në dëgjim publik siç e thotë edhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë.

Ai në vazhdim tha se materiali është çështje që diskutohet, pasurohet, rekomandohet për heqje, ngritje apo zbritje. Por një çështje që është me rëndësi ndoshta edhe për çështjen e pagës kishte me qenë mirë që të përfshihet edhe Drejtoria e Financa sepse gjatë dërgimit të rregullores duhet të jepen edhe disa impakte financiare që mund t'i ketë Komuna dhe drejtoria, pra e jep një fletë dhe flet për këtë çështje. Pra do të ishte mirë me u llogaritur çështja nëse është tek çmimi meqë është në prag të diskutimit që pastaj kur të vjen për votim atëherë mundet me u diskutuar me disa informata shtesë. Si dhe për mua do të ishte me rëndësi që me qenë një mesatare e pagës që është për qytetarë.

Ai në mes tjerash tha se për mua do të ishte më e rëndësishme që nëse ngritja ose rregullimi i disa çështjeve ku me këtë Rregullore do të përfshinte zgjerimin e ofrimeve të shërbimeve të paktën të disa fshatrave që janë në kryeqytet siç janë; zona e fshatrave nga ana e Llapit, Gollakut, sepse thënë të drejtën 18 prill ditën e dëshmorëve si kryeqytet nuk e gëzojmë një praktikë të mirë të organizimit të varrezave çoftë për dëshmorë, çoftë për të dashurit tonë që ndërrojnë jetë sepse i kemi të shpërndara në zona të ndryshme dhe jo mirë të organizuara.

Pra është mirë që në këtë rregullore me përfshirë diçka që rregullon e të paktën me e rregulluar zgjerimin e shërbimeve nga ndërmarrja, duke i plotësuar kushtet që ndërmarrja me pas mundësi me operuar edhe në këto zona për të ju shërbyer qytetarëve më mirë.

Nora Cimili: – duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Retkoceri tha se normalisht se si ndërmarrje kemi pasur ndër vite kërkesa edhe prej fshatrave të rrethit të Prishtinës, për me operuar atje çoftë për hapjen e varreve, shërbimet e varrimit, çoftë për mirëmbajtjen e varrezave, por nuk kemi mundur për shkak të numrit të kufizuar të punëtorëve. Normalisht kjo lidhet me financa dhe planin e biznesit, mirëpo në momentin kur do të kemi më shumë të hyra kemi me pasur mundësi me e riformuluar edhe njëherë planin e biznesit e pastaj me paraparë edhe punëtorë shtesë për pika të tjera.

Valbona Makolli: - shtroi pyetje se në kohën kur janë bërë krahasimet me komunat tjera a janë përfshirë shërbimet e tjera të transportit etj.

Nora Cimili: – tha se po janë të përfshira se shumica e kanë me transport.

Pika e dymbëdhjetë

Propozim – vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për “Muzeun e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”, i themeluar dhe menaxhuar nga “Fondacioni Jahjaga”.

Për shkak të mungesës së materialit për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka pasur diskutime.

**Pika e trembëdhjetë
Të ndryshme.**

Nuk pati diskutime.

**Procesmbajtësi/ja
Lendita Spahija**

**Kryesuesi i Komitetit
Fehmi Kupina**

